



|  |                            |
|--|----------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO                          |                            |
| AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT<br>AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE<br>ANTI-CORRUPTION AGENCY |                            |
| Dep.   | Nr. Prot.                  |
| Dep. <b>2-D/DPK</b>  | B. Prot. <b>01-1587/13</b> |
| Dep.   | Prot. No.                  |
| Nr. Flag.  | Dat.                       |
| Broj stranaica   | Datum                      |
| Nr. pages <b>02</b>  | Dat. <b>28.05.2013</b>     |



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI - CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 10 dhe 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 29 paragrafi 1 pika e) të Rregullores së Punës të Agjencisë Kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë Kundër Korrupsionit me datë **23.05.2013**, nxjerr këtë:

**V E N D I M**

***I. Mbyllet rasti me Nr. AKK-03-240/13 për ztr. Dragisa Krstovic – Këshilltar Politik në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal të Kosovës, për shkak se është parandaluar situata e mundshme e konfliktit të interesit gjatë ushtrimit të funksionit publik.***

**A r s y e t i m**

I. Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në ushtrimin e funksionit publik, nr. AKK-03-240-13, për Zyrtarin e lartë, z. Dragisa Krstovic – Këshilltar Politik në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe njëkohësisht person i autorizuar në një biznes privat, është trajtuar sipas procedurës së paraparë ligjore, për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Ligji Nr. 04/L-051).

Në rastin me numër protokoli AKK-03-240/13, të dyshuar për ekzistimin e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik, zyrtari i lartë, z. Krstovic së pari është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit, pas të cilës zyrtari është paraqitur në takim me zyrtarët e Agjencisë, me ç'rast është njoftuar me situatën në të cilën ndodhet si dhe me ndryshimet që duhet të bëjë për të parandaluar situatën e mundshme të konfliktit të interesit.

Zyrtari i lartë, ztr.Krstovic është deklaruar se do të heq dorë nga të qenurit person i autorizuar i biznesit privat, për të vazhduar të ushtrroj funksionin e tij publik, pa konflikt të mundshëm të interesit.

Ndërkohë, pas këtij takimi, z. Krstovic, në Agjenci ka dërguar informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, në të cilën shihet se z.Krstovic ka hequr dorë nga funksioni i personit të autorizuar në ndërmarjen private P.P."AKS" në të cilën tashmë nuk ushtron asnjë lloj funksioni.

Andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtari i lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit

\_\_\_\_\_  
/ Hasan Preteni /

